



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA TIRANË



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA  
DISKRIMINIMI

Nr. 4019 Prot, datë 19.04.2013

Nr. 288 Prot, datë 19.04.2013

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Mbi

“ BASHKËRENDIMIN E NDËRSJELLTË DHE RECIPROK TË VEPRIMTARISË  
INSTITUCIONALE TË PUNËS PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI ”

Lidhur sot, më datë 19 / 04 / 2013, në Tiranë ndërmjet:

**BASHKISË SË TIRANËS**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë **z. Lulzim Basha**, me adresë: shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, këtej e tutje e quajtur “**Bashkia**”;

**KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**, përfaqësuar nga Komisioneria znj. Irma Baraku, me adresë: Rruga Sami Frasheri, Nr.10.

këtu e në vijim së bashku referuar si Palët,

*Duke vlerësuar rëndësinë e promovimit, garantimit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit;*

*Duke u angazhuar për marrjen përsipër për sigurimin e të gjitha mjeteve të nevojshme për mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;*

*Duke konsideruar* si domosdoshmëri ushtrimin e ndërsjelltë të veprimtarisë institucionale me qëllim realizimin e interesave të ligjshme të personave mbështetur në parimin e barazisë përpara ligjit dhe barazisë së shanseve e mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë;

*Duke afirmuar* vullnetin e mirë dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksion të realizimit të qëllimit të këtij memorandumi;

*Duke u mbështetur* në kuadrin e plotë ligjor që rregullon veprimtarinë e tyre institucionale dhe administrative: në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*" dhe në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*", i ndryshuar;

*Kanë rënë dakord* të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi (në vijim "*Memorandumi*").

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij Memorandumi është, bashkërendimi i ndërsjelltë dhe reciprok i veprimtarisë institucionale të punës midis Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Bashkisë Tiranë, me qëllim ndjekjen, kujdesjen, garantimin, ofrimin e shërbimeve cilësore duke marrë në konsideratë realizimin e interesit më të lartë të qytetarit, për marrjen pjesë në jetën publike, si dhe mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi apo çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, në funksion të respektimit dhe zbatimit të Kushtetutës ,
2. ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*" dhe legjisllacionit në fuqi.

## **Neni 2**

### **Forma e bashkëpunimit**

Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi realizohet nëpërmjet:

1. Nxitjes mbi sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për çështjet e mosdiskriminimit, për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe mjetet ligjore të disponueshme;

